



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 866

Datë: 26.12.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 17 pika o, nenit 40 paragrafi 2 pika e, i, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), si dhe në bazë të nenit 10 paragrafi 1 pika o, nenit 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë, 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -XIII- të mbajtur më datë: 21.12.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR EMËRTIMET E
RRUGËVE SI DHE EMËRTIME TË REJA

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve për emërtimet e rrugëve, si dhe emërtime të reja në Komunën e Malishevës.
2. Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi Komisioni do të jetë në përbërje prej 5 pesë anëtarëve:
 - 2.1. Luan Kryeziu nga radhët e Nisma Social-Demokrate - anëtar
 - 2.2. Ali Morina nga radhët e PDK-së-anëtar
 - 2.3.nga radhët e LDK-së-anëtar
 - 2.4. Ilaz Krasniqi nga radhët e VV-së-anëtar
 - 2.5.nga zyra e Kryetarit të Komunës
3. Komisioni pas shqyrtimit të ankesave të qytetarëve për emërtimet e rrugëve, do t'i rekomandoj Kuvendit të Komunës për vendosje në lidhje me ankesat në fjalë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset: Kryetari i Komunës, përmes organeve tjera kompetente.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

MAPL-së

Drejtorive të KK-së

Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Brahim Morina

